



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1007

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së OE " ENERGY PLUS " SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ngrohja, klimatizimi – Muzeu Etnografik” me numër të prokurimit 632-25-7679-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS, më 27/11/2025, mori këtë:

Vendim

1. **Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e " ENERGY PLUS " SH.P.K. me nr. 2025/1007, e datës 10/10/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ngrohja, klimatizimi – Muzeu Etnografik”, me numër të prokurimit 632-25-7679-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – KOMUNA E GJAKOVËS.

2. **Mbetet në fuqi** B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - KOMUNA E GJAKOVËS për aktivitetin e prokurimit “Ngrohja, klimatizimi – Muzeu Etnografik”, me numër të prokurimit 632-25-7679-5-2-1.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 21.08.2025 KOMUNA E GJAKOVËS., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Ngrohja, klimatizimi – Muzeu Etnografik”, me numër të prokurimit 632-25-7679-5-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 70,436 €.

Me 24.08.2025 KOMUNA E GJAKOVËS., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin mbi vendimin e AK B58, ku është rekomanduar për kontratë OE "Albi Company SH.P.K.".

Me 26.09.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 30.09.2025 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 10.10.2025, OE " ENERGY PLUS " SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/1007, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, kundër njoftimit për dhenie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues " ENERGY PLUS " SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

AK/Komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, përkatësisht dispozitat ligjore të lartcekura dhe Rregulloren e Udhëzimit operativ për prokurim publik.

AK/Zyra e prokurimit me datë 24.09.2025 ka nxjerrë njoftimin mbi vendimin e AK, duke na eliminuar neve edhe pse jemi të përgjegjshëm me çmimin më të lirë, dhe duke rekomanduar për kontratë OE të papërgjegjshëm me çmimin më të lartë prej 8,508.00 euro.

Mund të thuhet se gjatë procedurës së vlerësimit të tenderëve, AK nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të LPP-së, për shkak se gjatë mënyrës dhe metodës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit dhe dispozitat ligjore që përcaktojnë kushtet dhe kërkesat e trajtimit të barabartë të OE në procesin e vlerësimit.

Në përputhje me nenin 108/A të LPP-së kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim me datë 26.09.2025.

Vendimin e kërkesës për rishqyrtim si të pabazuar e kemi pranuar me datë 30.09.2025.

Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues nuk është i bazuar në fakte dhe nuk e pasqyron gjendjen reale dhe faktike të procedurës së prokurimit.

Nuk pajtohem me vendimin për eliminimin tonë nga procedura për arsye të mungesës së nënshkrimit dhe vulës së personit të autorizuar, pasi jemi në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit.

Në vijim të kësaj ankese, do të paraqesim në mënyrë të qartë, të detajuar dhe të argumentuar për secilin nga pretendimet tona ankimore. Këto pretendime do të mbështeten në prova konkrete dhe dokumentacion përkatës, përmes të cilave vërehet qartë se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe me obligimet që burojnë nga dokumentet e tenderit.

Pretendimi 1 – Eliminimi i padrejtë dhe tendencioz

Nuk pajtohem me vendimin për eliminimin tonë nga procedura për arsye të mosnënshkrimit nga personi i autorizuar.

Argumenti ynë:

DEKLARATA PËR THEMELIMIN E GRUPIT nga ne si GOE është e marrë nga Dosja e Tenderit për këtë projekt dhe kemi dorëzuar marrëveshjen e themelimit të grupit sipas formularit standard të miratuar nga KRPP me datë 11.11.2024.

Ne, anëtarët e konsorciumit Energy Plus SHPK dhe Nika Pro Ing SHPK, kemi lidhur marrëveshjen për themelimin e grupit për këtë projekt ku për lider të grupit kemi autorizuar OE ENERGY PLUS që e përfaqëson z. Halim Halimi.

Shih

c. Ne të gjithë anëtarët e grupit e autorizojmë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe ai është: ENERGY PLUS SHPK.

Në vendimin e AK për refuzim të kërkesës është cekur se i mungon pjesa ku shënon Lideri; kjo metodë e manipulimit dhe shpifjeve ashiqare është shumë diskriminuese dhe jo transparente.

Shih deklaratën e nënshkruar dhe vulosur nga Lideri-pronari dhe anëtari i grupit 1.

Të nderuar ekspert shqyrtues dhe panel i OSHP-së, a keni mundësi të shikoni se si AK përdor gjëra të pavërteta sikur kjo me liderin vetëm për të na eliminuar me çdo kusht?

Kjo metodë e eliminimit është mjaft qesharake dhe tendencioze, ngase pronarët e kompanive e kanë nënshkruar dhe vulosur deklaratën konform LPP-së.

Është për t'u habitur fakti se si në një pozicion si zyrtar publik që janë, mundohen të përdorin gjëra të pavërteta (sikur kjo me liderin), kur të gjitha faktet gjenden në E-prokurim.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me vetëdije ka bërë shkelje flagrante të LPP-së dhe Rregullores Nr. 002/2024, e cila rregullore është vazhdimësi e LPP-së, duke manipuluar dhe shpikur gjëra të pavërteta.

Neni 97 — Shkeljet e rënda

Rregullore për Prokurimin Publik – Versioni i konsoliduar

97.1 Shkelje të rënda konsiderohen:

- a. Mashtrimi, kërcënim apo ushtrimi i çfarëdo presioni ose ndikimi të çfarëdo lloji që ushtrohet ndaj zyrtarit të prokurimit ose ndaj një personi tjetër të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, në mënyrë që zyrtari tjetër të kryejë vlerësimin në kundërshtim me këtë ligj.
- b. Falsifikimi, fshehja apo eliminimi i dokumenteve gjatë zhvillimit të një procedure të prokurimit;
- c. Nëse ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë për sjellje të gabuar apo jo profesionale të një zyrtari të prokurimit ndaj operatorit ekonomik apo ndaj cilitdo person gjatë ushtrimit të procedurës së prokurimit.

Konform Ligjit për Prokurim Publik, veprimet e ZPP-së konsiderohen shkelje të rënda, ku me këtë rast arrihet deri te revokimi i certifikatës profesionale të prokurimit.

Neni 99 — Masat disiplinore për shkeljet e rënda

Rregullore për Prokurimin Publik – Versioni i konsoliduar

99.2 Për shkelje të rënda të dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik dhe legjislacionit dytësor, duke përfshirë edhe ato të specifikuara në paragrafin 97.1 të kësaj rregulloreje, Bordi i KRPP-së do të nxjerrë vendim për anulim të certifikatës së prokurimit dhe do të kërkojë nga autoriteti kontraktues marrjen e masave disiplinore ndaj personit në fjalë në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

Kësaj nuk i thuhet ndryshe përveç diskriminim ndaj nesh si OE të përgjegjshëm me çmimin më të lirë.

Një veprim i tillë përbën tejkalim të kompetencave që i janë dhënë ZPP-së dhe cenon sigurinë juridike të operatorëve ekonomikë dhe parimin e parashikueshmërisë dhe paanësisë së vlerësimit.

Edhe njëherë theksojmë se nuk ju kemi larguar asnjë pjese ku është lideri, por haptazi po shihet se ju e keni për qëllim eliminimin tonë të padrejtë duke shpikur gjëra të pavërteta.

Edhe njëherë ju themi se NE NUK KEMI HEQUR PJESËN TE LIDERI, POR E KEMI PLOTËSUAR, NËNSHKRUAR E VULOSUR.

Marrëveshja e themelimit të grupit të operatorëve ekonomik është konform formularit standard të vendosur në Dosjen e Tenderit nga Autoriteti Kontraktues.

Kërkojmë që ky pretendim të merret seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, me parimet themelore të LPP-së dhe me vendimet e OSHP-së.

Përsëri e cekim se DEKLARATA PËR THEMELIMIN E GRUPIT nga ne si GOE është nxjerrë nga Dosja e Tenderit dhe dorëzuar konform formularit standard të miratuar nga KRPP me datë 11.11.2024.

Duke u bazuar në argumentet e lartcekura, kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pabazuar dhe njëkohësisht është arsyetim manipulues me të pavërteta, duke mos dhënë asnjë arsyetim konkret se përse pretendimi ynë ankimor është i pabazuar.

Andaj, ky veprim i AK-së e tregon qartë faktin se pretendimet tona ankimore janë të BAZUARA.

Autoriteti Kontraktues NUK e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si Operator Ekonomik të përgjegjshëm me çmimin më të lirë, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë; nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi, por po shihet se qëllimi i juaj është që ne të mos shpallemi fitues.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do t’i trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.”

Po ashtu, paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu, AK nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së, edhe pse autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Autoriteti Kontraktues duhet të ketë në konsideratë se oferta jonë është më e lirë se oferta të cilën ju keni rekomanduar për ta shpërblyer me kontratë për 8,508.00 euro; andaj ju, në mënyrë të vetëdijshme, keni tentuar të dëmtoni buxhetin e Republikës së Kosovës.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Ne, anëtarët e grupit, lidhim këtë marrëveshje me të cilën deklarojmë:

- a. Ne të gjithë anëtarët e grupit jemi bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës.
- b. Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë pjesëmarrjen tonë në grup dhe se nuk jemi duke marrë pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në procedurën e njëjtë të prokurimit.
- c. Ne të gjithë anëtarët e grupit e autorizojmë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe ai është: [Shëno emrin e liderit të grupit].

d. Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë se jemi të përshtatshëm dhe do të sigurojmë dëshmitë mbi përshtatshmërinë, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të FDT-së.

e. Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë pjesëmarrjen tonë në grup dhe deklarojmë se % (përqindja) e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës është:

a) [Shëno % (përqindjen) e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës të Liderit];

b) [Shëno % (përqindjen) e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës të anëtarit].

Shto sipas nevojës...

f. Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë përgjegjësitë e secilit anëtar:

a) [Shëno përgjegjësitë e Liderit];

b) [Shëno përgjegjësitë e anëtarit].

Shto sipas nevojës...

g. Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë se, në rast të shfrytëzimit të së drejtës për ankesë siç parashihet në nenet 108A dhe 109 të LPP-së, të drejtën për të dorëzuar kërkesën për rishqyrtim/ankesën e ka vetëm lideri i grupit të OE.

h. Ne të gjithë anëtarët e grupit pranojmë që, nëse një anëtar i grupit tërhiqet pas dorëzimit të tenderit (gjatë fazës së vlerësimit), Autoriteti Kontraktues të vazhdojë me anëtarin e mbetur, nëse anëtar i mbetur i plotëson kushtet e parapara në Dosje të Tenderit. Po ashtu, ne pranojmë që në këtë rast ndaj anëtarit i cili tërhiqet nga grupi, Autoriteti Kontraktues të iniciojë procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-së.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 14.10.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/1007, ndërsa me datë 24.10.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/1007, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e papabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashitë të tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashitë dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e

prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE" ENERGY PLUS " SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1007 ka vlerësuar si në vijim:

AK/Komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, përkatësisht dispozitat ligjore të lartcekura dhe Rregulloren e Udhëzimit operativ për prokurim publik.

AK/Zyra e prokurimit me datë 24.09.2025 ka nxjerrë njoftimin mbi vendimin e AK, duke na eliminuar neve edhe pse jemi të përgjegjshëm me çmimin më të lirë, dhe duke rekomanduar për kontratë OE të papërgjegjshëm me çmimin më të lartë prej 8,508.00 euro.

Mund të thuhet se gjatë procedurës së vlerësimit të tenderëve, AK nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të LPP-së, për shkak se gjatë mënyrës dhe metodës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit dhe dispozitat ligjore që përcaktojnë kushtet dhe kërkesat e trajtimit të barabartë të OE në procesin e vlerësimit.

Në përputhje me nenin 108/A të LPP-së kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim me datë 26.09.2025.

Vendimin e kërkesës për rishqyrtim si të pabazuar e kemi pranuar me datë 30.09.2025.

Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues nuk është i bazuar në fakte dhe nuk e pasqyron gjendjen reale dhe faktike të procedurës së prokurimit.

Nuk pajtohem me vendimin për eliminimin tonë nga procedura për arsye të mungesës së nënshkrimit dhe vulës së personit të autorizuar, pasi jemi në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit.

Në vijim të kësaj ankese, do të paraqesim në mënyrë të qartë, të detajuar dhe të argumentuar për secilin nga pretendimet tona ankimore. Këto pretendime do të mbështeten në prova konkrete dhe dokumentacion përkatës, përmes të cilave vërehet qartë se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe me obligimet që burojnë nga dokumentet e tenderit.

Pretendimi 1 – Eliminimi i padrejtë dhe tendencioz Nuk pajtohem me vendimin për eliminimin tonë nga procedura për arsye të mosnënshkrimit nga personi i autorizuar.

Argumenti ynë:

DEKLARATA PËR THEMELIMIN E GRUPIT nga ne si GOE është e marrë nga Dosja e Tenderit për këtë projekt dhe kemi dorëzuar marrëveshjen e themelimit të grupit sipas formularit standard të miratuar nga KRPP me datë 11.11.2024.

Ne, anëtarët e konsorciumit Energy Plus SHPK dhe Nika Pro Ing SHPK, kemi lidhur marrëveshjen për themelimin e grupit për këtë projekt ku për lider të grupit kemi autorizuar OE ENERGY PLUS që e përfaqëson z. Halim Halimi.

Shih

c. Ne të gjithë anëtarët e grupit e autorizojmë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe ai është: ENERGY PLUS SHPK.

Në vendimin e AK për refuzim të kërkesës është cekur se i mungon pjesa ku shënon Lideri; kjo metodë e manipulimit dhe shpifjeve ashiqare është shumë diskriminuese dhe jo transparente.

Shih deklaratën e nënshkruar dhe vulosur nga Lideri-pronari dhe anëtari i grupit 1.

Të nderuar ekspert shqyrtues dhe panel i OSHP-së, a keni mundësi të shikoni se si AK përdor gjëra të pavërteta sikur kjo me liderin vetëm për të na eliminuar me çdo kusht?

Kjo metodë e eliminimit është mjaft qesharake dhe tendencioze, ngase pronarët e kompanive e kanë nënshkruar dhe vulosur deklaratën konform LPP-së.

Është për t'u habitur fakti se si në një pozicion si zyrtar publik që janë, mundohen të përdorin gjëra të pavërteta (sikur kjo me liderin), kur të gjitha faktet gjenden në E-prokurim.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me vetëdije ka bërë shkelje flagrante të LPP-së dhe Rregullores Nr. 002/2024, e cila rregullore është vazhdimësi e LPP-së, duke manipuluar dhe shpikur gjëra të pavërteta.

Neni 97 — Shkeljet e rënda Rregullore për Prokurimin Publik – Versioni i konsoliduar

97.1 Shkelje të rënda konsiderohen:

a. Mashtrimi, kërcënimi apo ushtrimi i çfarëdo presioni ose ndikimi të çfarëdo lloji që ushtrohet ndaj zyrtarit të prokurimit ose ndaj një personi tjetër të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, në mënyrë që zyrtari tjetër të kryejë vlerësimin në kundërshtim me këtë ligj.

b. Falsifikimi, fshehja apo eliminimi i dokumenteve gjatë zhvillimit të një procedure të prokurimit;

c. Nëse ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë për sjellje të gabuar apo jo profesionale të një zyrtari të prokurimit ndaj operatorit ekonomik apo ndaj cilitdo person gjatë ushtrimit të procedurës së prokurimit.

Konform Ligjit për Prokurim Publik, veprimet e ZPP-së konsiderohen shkelje të rënda, ku me këtë rast arrihet deri te revokimi i certifikatës profesionale të prokurimit.

Neni 99 — Masat disiplinore për shkeljet e rënda Rregullore për Prokurimin Publik – Versioni i konsoliduar

99.2 Për shkelje të rënda të dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik dhe legjislacionit dytësor, duke përfshirë edhe ato të specifikuara në paragrafin 97.1 të kësaj rregulloreje, Bordi i KRPP-së do të nxjerrë vendim për anulim të certifikatës së prokurimit dhe do të kërkojë nga autoriteti kontraktues marrjen e masave disiplinore ndaj personit në fjalë në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

Kësaj nuk i thuhet ndryshe përveç diskriminim ndaj nesh si OE të përgjegjshëm me çmimin më të lirë.

Një veprim i tillë përbën tejkalim të kompetencave që i janë dhënë ZPP-së dhe cenon sigurinë juridike të operatorëve ekonomikë dhe parimin e parashikueshmërisë dhe paanësisë së vlerësimit.

Edhe njëherë theksojmë se nuk ju kemi larguar asnjë pjese ku është lideri, por haptazi po shihet se ju e keni për qëllim eliminimin tonë të padrejtë duke shpikur gjëra të pavërteta.

Edhe njëherë ju themi se NE NUK KEMI HEQUR PJESËN TE LIDERI, POR E KEMI PLOTËSUAR, NËNSHKRUAR E VULOSUR.

Marrëveshja e themelimit të grupit të operatorëve ekonomik është konform formularit standard të vendosur në Dosjen e Tenderit nga Autoriteti Kontraktues.

Kërkojmë që ky pretendim të merret seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, me parimet themelore të LPP-së dhe me vendimet e OSHP-së.

Përsëri e cekim se DEKLARATA PËR THEMELIMIT të grupit nga ne si GOE është nxjerrë nga Dosja e Tenderit dhe dorëzuar konform formularit standard të miratuar nga KRPP me datë 11.11.2024.

Duke u bazuar në argumentet e lartcekura, kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pabazuar dhe njëkohësisht është arsyetim manipulues me të pavërteta, duke mos dhënë asnjë arsyetim konkret se përse pretendimi ynë ankimor është i pabazuar.

Andaj, ky veprim i AK-së e tregon qartë faktin se pretendimet tona ankimore janë të BAZUARA.

Autoriteti Kontraktues NUK e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si Operator Ekonomik të përgjegjshëm me çmimin më të lirë, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë; nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi, por po shihet se qëllimi i juaj është që ne të mos shpallemi fitues.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do t’i trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.”

Po ashtu, paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu, AK nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së, edhe pse autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Autoriteti Kontraktues duhet të ketë në konsideratë se oferta jonë është më e lirë se oferta të cilën ju keni rekomanduar për ta shpërblyer me kontratë për 8,508.00 euro; andaj ju, në mënyrë të vetëdijshme, keni tentuar të dëmtoni buxhetin e Republikës së Kosovës.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të lejohet Autoritetit Kontraktues KOMUNA E GJAKOVËS., të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit “Ngrohja, klimatizimi – Muzeu Etnografik”, me numër të prokurimit 632-25-7679-5-2-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - " ENERGY PLUS " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: